

AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ALBANIAN TOURISM AND LOGISTICS (ATL) SH.P.K.

KAPITULLI 1
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

NENI 1
Emërtimi i Shoqërisë

Sot me datë 14 Shtator 2023 Ortakët themelues, themelojnë shoqërinë tregtare private me përgjegjësi të kufizuar **Albanian Tourism and Logistics (ATL)** Sh.p.k., në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar në Republikën e Shqipërisë.

1.1 Shoqëria **Albanian Tourism and Logistics (ATL)** Sh.p.k (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar nga ortakët themelues **Lorin Hoxha** dhe **Luis Hoxha**, dhe që ekziston në përputhje me legjisacionin e Republikës së Shqipërisë.

1.2 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe në përputhje dhe në zbatim të Statutit të Shoqërisë të përditësuar në përputhje me ligjet e lartpërmëndura.

NENI 2
Selia e Shoqërisë

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Skenderbej, Kati III, ZK 8514, Nr. Pasurie: 4/208/ND-N3, Durrës.

2.2 Shoqëria mund të hapë zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale dhe/ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitet në vende të tjera, qoftë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, që mund të miratohen herë pas here.

NENI 3
Kohëzgjatja

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar që ekziston pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit.

NENI 4
Objekti i Shoqërisë

4.1 Ngarkim, shkarkim të mjeteve lundruese dhe aktivitetave të ngjashme siç janë depozitimi, magazinimi, grupimi, marrja dhe dorëzimi i ngarkesave etj. Servis. Ndërtim, projektim, studim, investim, në sektorin e energjisë elektrike në të gjitha llojet e impianteve gjeneruese nga burime të rrinovueshme të energjisë

1

elektrike, menaxhimi dhe operimi i veprave të ndryshme energetike. Ndërtimi i linjave të shperndarjes dhe transmetimit, import, eksport, tregtim, tranzitim, furnizim me pakicë i energjisë elektrike. Shërbim të hapësirave publicitare.

KREU II

KAPITALI SHOQËRISË, MARRËDHËNIET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ORTAKËVE ADRESA E ORTAKËVE, VULA E SHOQËRISË

NENI 5 Kapitali

5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 41.149.928,00 Lekë (dyzet e një milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë), i ndare në 2,00 kuota, me vlerë nominale prej 20.574.964,00 Lekë (njëzet milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) secila. Kapitali eshte nënshkruar nga Ortakët e mëposhtëm:

- Lorin Hoxha, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të Shoqërisë, të barabartë me vlerën e kapitalit 20.574.964,00 Lekë (njëzet milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër).

- Luis Hoxha zotërues i 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të Shoqërisë, të barabartë me vlerën e kapitalit 20.574.964,00 Lekë (njëzet milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër).

5.2 Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin e zbatueshëm. Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vleren e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

5.3 Kapitali i Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit

6.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7 Transferimi i kuotave të Kapitalit Themeltar

7.1 Kuotat e kapitalit mund të shiten nga ortakët e shoqërisë me vlerën nominale ose sipas një vlere tjetër të pranuar midis shitësit dhe blerësit. Shitia e kuotave duhet të jetë në përputhje me kuotat e poseduara nga ortakët dhe ju bëhet e njohur me akt të shkruar dhe regjistruar në rregjistrin e shoqërisë.

7.2 Administratoret duhet te njoftojë Ortaket e tjere qe kane te drejte te ushtrojne te drejten e parablerjes, dhe keta te fundit duhet te komunikojne vendimin e tyre brenda 10 diteve nga marrja e njoftimit per transferimin. Oferta mbi transferimin e kuotave duhet te permbaje te dhenat personale te shitesit si dhe kushtet dhe afatet e transferimit, vecanerisht cmimin dhe menyren e pageses.

2

7.3 Kuotat e kapitalit themeltar mund tu transferohen lirisht personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri nëse ky vendim është i aprovuar nga ortakët që përfaqësojnë totalisht të paktën 51% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

7.4 Kuotat e kapitalit, në rast vdekje i kalojnë trashëgimtarëve duke hyrë këta të fundit në shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut.

7.5 Kuotat janë lirisht te transferueshme me rruge trashegimie, ose kur kalimi i kuotave behet ne favor te bashkeshorit(es), si dhe pasardhësve ose pasardhesve te drejtperdrejtë te Ortakut.

NENI 8
Shpërnadarja e fitimit

8.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 9
Përgjegjësia e Shoqërisë

9.1 Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime.

9.2 Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore ndaj të tretëve. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve në veçanti, por për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

9.3 Ortakët nuk përgjigjen me pasurinë e tyre vetiakë për detyrimet e shoqërisë që vijnë nga veprimitaria që kryejnë në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët.

NENI 10
Adresa e Ortakëve

10.1 Adresa e ortakëve përsa i përket marrëdhënieve të tyre me shoqërinë është ajo e regjistruar në librin e ortakëve themelues të shoqërisë e cila mund të përditësohet. Do të jetë detyrim i ortakëve të komunikojnë me shkrim me anë të rekomandesë me lajmërim marrje që vërteton dorëzimin efektiv në një vendbanim të ndryshëm nga ai i deklaruar më parë. E njëjta procedurë do të zbatohet për çdo përditësim të mëtejshëm.


NENI 11
Vula e Shoqërisë

11.1 Shoqëria ka vulën e saj me të njëjtin emërtim si vetë shoqëria. Përdorimi i vulës është i rezervuar eksluzivisht administratorit, me përjashtim të një ortaku tjetër që të jetë posaçërisht i deleguar.

KREU III
ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 12
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

12.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë që përbëhet nga të gjithë ortakët.



3

12.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoro, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

12.3 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori/ët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 13

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

13.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpala datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

13.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në këtë mënyrë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

13.3 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë Administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet për të cilat Asambleja duhet të marrë vendim.

13.4 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve drejtohet nga Administratori nëse është e thirrur prej tij. Nëse Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesoitet nga njëri prej ortakëve i zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën 2 herë në vit.

NENI 14

Kuorumi dhe marrja e vendimeve

4

14.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të thjeshtë Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakët që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave, për të vendosur për çështje të zakonshme. Në këtë rast, vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga shumica e ortakëve pjesëmarrës.

14.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çëshjte të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipar Nenit 87 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse në të marrin pjesë ortakë që zoterojnë më shumë se 50% të kuotave. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se $\frac{3}{4}$ (tri të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës.

14.3 Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërnsarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

14.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:


- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve;
- mbikqyrjen e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimit;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve te Asamblesë.

NENI 15
E drejta e votës

15.1 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote duke kuptuar me shprehjen “çdo kuotë” posedimin e të paktën të një vlere 1% të kapitalit të shoqërisë. Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpëra apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

NENI 16
Përjashtimi nga e drejta e votës

16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimit së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



5

NENI 17
Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë

17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Prosesverbal i duhet të përbajë datën dhe vardin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Prosesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

NENI 18
Administrimi i Shoqërisë

18.1 Administrimi i shoqërisë realizohet nga Administratori i saj Z. Luis Hoxha, i datëlindjes 10.06.1988, lindur në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me Numër Personal Identifikimi I80610092C, i cili emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë riemërimit nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve dhe ushtron përfaqësimin e shoqërisë.

18.2 Konkretnisht, administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

18.3 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 19
Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

19.1 Administratori, përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, detyrohet: a) të kryejë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsëi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis; b) të ushtrojë kompetencat gë u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) të vlerësojë

6



me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; d) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë; e) të ushtrojë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

19.2 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

19.3 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

19.4 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme: a) u kthen ortakëve kontributet; b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) shpérndan aktivet e shoqërisë; d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; d) jep kredi.

KREU IV
VITI FINACIAR, EKSPERTI KONTABËL

NENI 20
Viti Financiar

20.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet më 31 Dhjetor.

NENI 21
Eksperti Kontabël

21.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij në rastet kur ai është ngarkuar dhe e ka kryer, i ngarkuar nga Ortakët.

21.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara për të cilat është i detyruar t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar në bazë të kompetencave të Asamblesë së Përgjithshme.

KREU V
LARGIMI I ORTAKËVE

NENI 22
Largimi i Ortakëve

22.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjera ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

22.2 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas paragrafit të parë të këtij nenit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

22.3 Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaget e largimit dhe likuidimin e kuotës.

22.4 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

22.5 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjera që shkaktuan largimin e tij dhe të kérkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

22.6 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria.

NENI 23 Përjashtimi i Ortakëve

23.1 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kérkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku: a) me dashje apo me pakujdesi të rënde shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjera; b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj; c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose d) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

23.2 Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërrkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

23.3 Shoqëria ka të drejtë t'i kérkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

23.4 Ortaku ka të drejtë t'i kérkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

23.5 Ortaku nuk ka të drejtë t'i kérkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngrëndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

23.6 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e vendimit të formës së prerë të gjykatës për përjashtimin. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

8

KREU VI
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 24
Prishja e Shoqërisë

24.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet: a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj; b) me vendim të asamblesë së përgjithshme; c) me hapjen e procedurave të falimentimit; d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; d) me vendim të gjykatës; dh) për arsyet e tjera, të parashikuara në statut.

NENI 25
Likujdimi i Shoqërisë

25.1 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

KREU VII
ZBATIMI I LIGJIT

NENI 26
Zbatimi i ligjit


Përsa nuk është parashikuar në këtë Statut vlejnë dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 27

Ky akt u redaktua në gjashtë kopje për t'ju shpërndarë ortakëve dhe organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

LORIN HOXHA



LUIS HOXHA

